

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI POPULLOR**

L I G J

Nr. 7971, date 26. 7. 1995

PER PROKURIMIN PUBLIK

Ndryshuar me ligjet nr.8039, date 23.11.1995, nr.8074, date 22.2.1996, nr.8112, date 28.3.1996 dhe nr.8767, date 5.4.2001, **Nr.9064 dt.08.05.2003**

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qellimi i ketij ligji

" Ky ligj percakton rregullat per prokurimet e mallrave, te ndertimeve dhe te sherbimeve dhe synon:

- a) te nxise perdorimin ekonomik dhe efektiv te fondeve publike nga entet prokuruese;
- b) te nxise pjesemarrjen e kandidatave ne procedurat e prokurimit publik;
- c) te nxise konkurrencen ne prokurim ndermjet kandidatave per furnizimin me mallra, per ndertime dhe per sherbime;
- ç) te siguroje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues te te gjithe kandidatave pjesemarres ne prokurim;
- d) te siguroje ndersherime, besimin publik dhe arritjen e transparences ne prokurimin publik;

Neni 2

PERKUFIZIME

Ne kete ligj:

"Prokurim" do te thote blerja, marrja me qira ose cdo menyre tjeter kontraktimi i mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve.

"Ent prokurues" eshte cdo organ shteteror qendror a lokal, si dhe cdo person juridik tjeter, qe i vihen ne dispozicion fonde publike per prokurim.

" Prokurim publik" do te thote prokurimi nga entet prokuruese.

"Mallra" jane lendet e para, produktet, makinerite dhe paisjet, materialet ne forme te ngurte, te lengshme e te gazte dhe energjia elektrike, si dhe sherbimet lidhur me furnizimin e mallrave si transporti, instalimi, mirembajtja dhe detyrimet e tjera te ngjashme, nese vlera e tyre nuk e kalon ate te vete mallrave.

"Ndertime" janë të gjitha punimet që shoqërojnë ndertimin, rindertimin, shkatërrimin, riparimin a rinovimin e një objekti ose struktura të tilla si përgatitja e truallit, germimet, instalimi i paisjeve dhe i materialeve, zbulimet si dhe shërbimet që lidhen me to, nëse vlera e këtyre shërbimeve nuk e kalon atë të vetë ndertimeve.

"Shërbime" janë çdo objekt prokurimi, përveç mallrave dhe ndertimeve.

"Shërbime Keshillimore" janë shërbimet e keshillimit me natyrë intelektuale.

"Tender" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën ftohen, shqyrtohen dhe vlerësohen të gjitha ofertat e marra për të zgjedhur ofertën më të mirë për të lidhur kontratë.

"Tenderi i hapur" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën të gjithë kandidatët e interesuar mund të paraqesin ofertat e tyre.

"Tenderi i kufizuar" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën vetëm kandidatët e ftuar nga entiteti prokurues mund të paraqesin oferta.

"Tender me dy faza" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën entiteti prokurues kërkon oferta në dy faza: në fazën e parë oferta për informacion të plotë pa çmime, kurse në fazën e dytë oferta me çmime.

"Kërkese për propozim" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën entiteti prokurues kërkon propozime nga kandidatët e zgjedhur prej tij.

"Prokurimi i drejtperdrejtë" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën entiteti prokurues kontakton dhe kërkon një propozim nga një kandidat.

"Kërkese për kuotim" do të thotë një procedurë prokurimi, në të cilën entiteti prokurues kërkon kuotime nga kandidatët e zgjedhur prej tij.

"Kandidat" do të thotë një person fizik ose juridik, i ftuar për të marrë pjesë në prokurimin publik ose që kërkon të ftohet.

"Ofertues" do të thotë një person fizik a juridik që paraqet një ofertë.

"Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik, që ka lidhur një kontratë për mallra, ndertime dhe shërbime me entitetin prokurues.

"Rregullat e prokurimit" janë rregullat e nxjerra nga organi kompetent në bazë të këtij ligji.

"Dokumentet e tenderit" janë dokumente që entiteti prokurues ve në dispozicion të kandidatëve si bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

"Fonde publike" do të thotë:

- a) Çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit që është përcaktuar të përdoret për prokurim publik.
- b) Çdo vlerë monetare e buxhetit vendor që është përcaktuar të përdoret për prokurim publik.
- c) Fondet e dhëna si ndihmë ose kredi nga donatorë të huaj, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat nuk kërkohen të zbatohen procedurat e ndryshme nga ky ligj.
- ç) Të ardhurat e ndërmarrjeve shtetërore, të ndërmarrjeve bashkiake dhe të shoqërive tregtare, me përberje kapitali në të cilën shteti ka shumicën."

"Pezullim" do të thotë ndërprerje e procedurës së prokurimit nga kryetari i entitetit prokurues, nga organi qendror ose vendor ose nga agjencia e Prokurimit Publik, si rezultat i ankimit administrativ.

"Rivlerësim" do të thotë rishikim dhe korrigjim i të metave të vëna re nga kryetari i entitetit prokurues, nga organi qendror ose vendor ose nga Agjencia e Prokurimit Publik në një procedurë prokurimi.

"Anullim" do të thotë përsëritje nga fillimi i një procedurë prokurimi, si rezultat i shkeljeve të rregullave të prokurimit, të vëna re nga organi qendror ose vendor, ose nga Agjencia e Prokurimit Publik."

Neni 3

Fusha e zbatimit

a) Ky ligj zbatohet për të gjitha prokurimet publike, përveç rasteve kur Keshilli i Ministrave, për arsye të interesit të sigurimit ose mbrojtjes kombëtare, mund të përcaktojë një procedurë tjetër për prokurimin publik të mallrave, ndertimeve e shërbimeve.

b) Procedurat e këtij ligji nuk zbatohen për fondet publike për veprimtarinë shkencore dhe zhvillimin teknologjik.

Neni 4

Detyrime nderkombetare

Ne rast se ky ligj bie ndesh me nje detyrim qe shteti ka ne baze te nje marreveshjeje me nje shtet, ose me disa shtete te tjera a me nje institucion nderkombetar, atehere duhet te respektohen kushtet e marreveshjes ne fjale. Ne te gjitha rastet e tjera prokurimi publik duhet te behet ne baze te ketij ligji.

Neni 5

Rregullat e prokurimit

- (1) Keshilli i Ministrave ngarkohet te hartoje dhe shpalle rregullat e prokurimit per plotesimin e qellimit dhe zbatimin e dispozitave te ketij ligji.
- (2) Ne qofte se me shume se nje ent prokurues ka nevoje per te njejtin lloj malli, ndertimi ose sherbimi, Keshilli i Ministrave mund t'i caktoj njerit nga ato ente prokuruese detyren e prokurimit publik te mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve te tilla ne emer te tyre.
- (3) Enti prokurues, ne fillim te çdo viti, sipas afateve te vendosura ne rregullat e prokurimit publik, sjell ne Agjencine e Prokurimit Publik planifikimin vjetor te prokurimeve per publikim ne Buletinin e Prokurimit Publik.

Neni 6

Disponueshmeria e dokumentacionit ligjor per publikun

Ky ligj, rregullat e prokurimit, si dhe te gjitha udhezimet e Agjencise se Prokurimit Publik, do te vihen menjehere ne dispozicion te publikut dhe kjo disponueshmeri do te respektohet sistematikisht.

KREU II

ORGANIZIMI I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 7

Pergjegjesia e entit prokurues

- (1) Enti prokurues eshte pergjegjes per prokurimin me fonde publike qe i vihen ne dispozicion, duke iu nenshtruar dispozitave te ketij ligji dhe cdo kushti tjetër qe perfshihet ne rregullat e prokurimit dhe udhezimet e Agjencise se Prokurimit Publik.
- (2) Enti prokurues, sipas kufijve monetare te percaktuar ne rregullat e prokurimit, perpara se te shpalle oferten ose propozimin fitues, duhet te paraqese te titullari i organeve qendrore ose lokale perkates ose ne Keshillin e Ministrave per shqyrtim: paraprak e miratim nje raport permbledhes te procedures se prokurimit, i cili permban:
 - (a) gjykimin per zgjedhjen e nje procedure prokurimi, pervec tenderit te hapur;
 - (b) vleresimin e ofertave ose propozimeve te marra;
 - (c) vendimin e marre per oferten ose propozimin fitues.
- (3) Enti prokurues duhet te vere ne dispozicion te Agjencise se Prokurimit Publik per inspektim dokumentacionin e plote dhe procesverbalet e prokurimit publik, si dhe duhet te paraqese me hollesi e ne cdo kohe, kur Agjencia e Prokurimit Publik mund t'i kerkoje, raporte ne lidhje me veprimtarite e tyre te prokurimit publik.
- (4) Enti prokurues eshte i detyruar te ngreje njesine e prokurimit brenda strukturave

te veta, detyrat e se ciles percaktohen ne udhezimet e Keshillit te ministrave.

Neni 8

Agjencia e Prokurimit Publik

(1) **Agjencia e Prokurimit Publik eshte organi qendror, person juridik,publik,buxhetor,ne varesi te Kryeministrit.**

(2) Ne kryerjen e detyrave te saj Agjencia e Prokurimit Publik :

(a) paraqet ne Keshillin e Ministrave propozime lidhur me rregullat e prokurimit;

(b) nxit dhe ndihmon ne kualifikimin e punonjesve te organeve qendrore e lokale, qe merren me prokurimin publik;

(c) harton dhe nxjerr nje buletin te prokurimit publik qe do te perdoret per botimin e ftesave per oferte dhe te njoftimeve te tjera ne lidhje me prokurimin publik. Ne fillim te cdo viti Agjencia e Prokurimit Publik boton ne Buletinin e Prokurimit Publik listen e ofertuesve, te perjashtuar nga marrja pjese ne prokurimet publike, sipas nenit 12 pika 5 dhe 7 te ketij ligji;

(ç) pergatit dokumentet standarde, qe do te perdoren ne lidhje me prokurimin publik;

(d) jep udhezime dhe, sipas kerkeses, keshilla e ndihme enteve prokuruese qe ndermarrin nje procedure prokurimi;

(dh) paraqet nje raport vjetor ne Keshillin e Ministrave ne lidhje me funksionimin e pergjithshem te sistemit te prokurimit publik;

(e) ne ate shkalle qe ajo e gjykon te nevojshme, inspekton dokumentet dhe procesverbalet e enteve prokuruese, me qellim qe te verifikoje zbatimin e tyre ne perputhje me kete ligj;

(ë) kryen shqyrtimin administrativ te ankesave, te parashikuar ne kreun VIII;

(f) bashkepunon me institucione nderkombetare dhe me ente te tjera te huaja per ceshtjet lidhur me sistemin e prokurimit publik;

(g) planifikon dhe koordinon ndihmen teknike te huaj ne fushen e prokurimit publik;

(gj) **Pergatit dhe shpall Regjistrin Qendror te Parashikimeve te Prokurimeve dhe Regjistrin Qendror te Realizimit te Prokurimeve .**

(h) nxit dhe mbeshtet perdorimin e standarteve teknike nderkombetare per pergatitjen e specifikimeve teknike, si dhe mban lidhje te vazhdueshme me Drejtorine Kombetare te Standartizimeve

(3) Drejtori i Agjencise se Prokurimit Publik emerohet,**lirohet** dhe shkarkohet nga **Kryeministri. (3/1) Per nenpunesit, drejtues dhe specialiste,te Agjencise se Prokurimit Publik zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin "Statusi i Nenpunesit Civil " ,ndersa per punonjesit e tjere zbatohen dispozitat e Kodit te Punes.**

(4) **Kryeministri** emeron gjithashtu nje grup konsultativ nderdikasterial, te perbere nga perfaqesues te enteve prokuruese kryesore te organeve qendrore e lokale, i cili do te jape keshilla dhe mendime lidhur me funksionimin ne pergjithesi te sistemit te prokurimit publik dhe per propozimet qe Agjencia e Prokurimit Publik do te paraqese per shqyrtim ne Keshillin e Ministrave.

KREU III

RREGULLA TE PERBASHKETA TE PROKURIMIT

Neni 9

Mosdiskriminimi mbi bazen e shtetesise

Personat fizike ose juridike nuk duhet te perjashtohen nga pjesemarrja ne prokurimin publik

per shkak te shtetesise se tyre.

Neni 10

Procesverbalet e prokurimit

(1) Enti prokurues duhet te mbaje procesverbalet e prokurimit publik me informacion te mjaftueshem per te lejuar kontrollin dhe verifikimin e respektimit te dispozitave te ketij ligji. Lidhur me cdo procedure prokurimi, procesverbali duhet te permbaje te pakten gjykimin e procedures se prokurimit te zgjedhur, pervec tenderit te hapur, informacion per mallrat, ndertimet dhe sherbimet qe do te prokurohen, emrat e kandidateve, emrin e furnizuesit, oferta ose propozimi i te cilit eshte shpallur fitues dhe vleften e kontrates.

(2) Informacioni i kerkuar ne paragrafin (1) duhet t'i behet i njohur, cdo personi te interesuar kundrejt kerkeses se tij, pasi te jete shpallur fituesi. Informacionet e tjera duhen te mbahen sekret.

(3) Enti prokurues ruan dhe dhe administron rregjistrin, dokumentat e tenderit dhe cdo dokuemnt qe lidhet me prokurimet ,sipas menyres dhe per kohen qe parashikohet ne ligjin per arkivatdhe ne ligjin e informimit publik.

Neni 11

Forma e komunikimit

Komunikimi ndermjet kandidateve dhe enteve prokuruese duhet te behet vetem me shkrim. Ne qofte se komunikimi behet ne nje forme tjetere, ai duhet t'i referohet vetem dokumentacionit me shkrim dhe permbajtja e atij komunikimi duhet te paraqitet me shkrim, menjehere pas atij komunikimi.

Neni 12

Kualifikimi i kandidateve

(1) Per te marre pjese ne prokurim publik kandidatet duhet te kualifikohen, duke plotesuar kriteret e meposhtme, qe enti prokurues i konsideron te nevojshme sipas rrethanave:

(a) ata duhet te kene aftesine e duhur profesionale, teknike dhe organizative, personel, burime financiare, makineri e paisje te tjera, reputacion dhe besueshmeri per zbatimin e kontrates;

(b) ata te kene kryer me pare kontrata te ngjashme e te peraferta me ato te percaktuara ne rregullat e prokurimit;

(c) ata duhet te kene zotesi juridike per te vepruar;

(ç) ata nuk duhet te jene te falimentuar, kapitalet e tyre nuk duhet te jene ne duart e permbaruesit ose te jene ne proces konfiskimi, veprimtarite e tyre te biznesit nuk duhet te jene te pezulluara dhe ata nuk duhet te jene ne ndjekje te procedurave ligjore per asnje nga ceshtjet e mesiperme;

(d) ata duhet t'i kene permbushur detyrimet e tyre per pagimin e taksave dhe te sigurimeve shoqerore, nga kandidati i huaj ky dokument mund te jete ne formen e deklarates me shkrim te nenshkruar prej tij.

(2) Enti prokurues mund t'u kerkoje kandidateve te paraqesin dokumente ose informacione te tjera, qe mund te konsiderohen te nevojshme, per te konkluduar se kandidatet jane kualifikuar ne perputhje me kriteret e permendura ne paragrafin (1).

(3) Cdo kerkese e parashikuar ne perputhje me kete nen duhet te perfshihet ne dokumentet e procedures se parakualifikimit, ne rast se do kete te tilla, dhe ne dokumentet e tenderit ose ne kerkesen per propozim dhe duhet te zbatohet ne menyre te barabarte per gjithë kandidatet.

(4) Enti prokurues duhet te vleresoje kualifikimet e kandidateve ne perputhje me

kriteret dhe procedurat e percaktuara ne dokumentet e permendura ne paragrafin (3).

(5) Enti prokurues duhet te skualifikoje nje kandidat, i cili per kualifikimin e tij paraqet nje dokument qe permban nje informacion te rreme. Ne kete rast enti prokurues mund ti propozoje Agjencise se Prokurimit Publik perjashtimin e kandidatit nga te gjitha prokurimet publike per nje periudhe kohe nga 1 deri ne 3 vjet. Nese Agjencia e Prokurimit Publik e miraton kete perjashtim, do ta botoje ne buletin e prokurimit publik.

(6) Enti prokurues duhet te skualifikoje nje kandidat, ne qofte se konstaton ne cdo kohe deri ne nenshkrimin e kontrates qe informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose te dhenat qe kane lidhje me vleresimin e kandidatit, jane te pasakta ose jo te plota.

(7) Agjencia e Prokurimit Publik, kur veren se skualifikimi i kandidateve eshte bere ne perputhje me nenin 12 pika 5 ose kur veren se nje kandidat paraqet nje dokument me informacion te rreme, merr vendim per perjashtimin e kandidatit nga prokurimet publike per nje periudhe kohe nga nje vit deri ne 3 vjet. Vendimin qe ajo merr ua komunikon te gjitha enteve prokuruese nepermjet botimit ne Buletin e Prokurimit Publik.

Neni 13

Procedura parakualifikuese

(1) Enti prokurues mund te zbatoje proceduren parakualifikuese, me qellim qe perpara se te behet paraqitja e ofertave, te verifikohet nese kandidatet jane kualifikuar. Perdorimi i procedures parakualifikuese eshte i domosdoshem si nje hap paraprak per tenderin e hapur ose me dy faza, per prokurimin e mallrave ose ndertimeve te medha dhe komplekse.

(2) Ne rast se enti prokurues do te zbatoje proceduren parakualifikuese, ai duhet te pergatite dokumentacionin e parakualifikimit ku te permbahet te pakten informacioni i meposhtem:

- (a) udhezime per pergatitjen dhe paraqitjen e kerkesave per parakualifikim;
- (b) te dhena kryesore te pergjithshme per natyren, sasine e mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve qe do te prokurohen;
- (c) kohet qe kerkohet per dorezimin e mallrave a perfundimin e ndertimit ose sherbimeve;
- (g) kriteret dhe procedurat qe do te perdoren per vleresimin e kualifikimit te kandidateve, sipas dispozitave te nenit 12;
- (d) nje permbledhje te kushteve kryesore te kontrates, e cila do te lidhet si rezultat i procedurave te prokurimit;

(dh) cdo te dhene dokumentare a informacion tjeter qe duhet te paraqitet nga kandidatet per te demonstruar kualifikimin e tyre;

(e) menyren dhe vendin e paraqitjes te kerkesave per parakualifikimin dhe afatin e fundit te paraqitjes se tyre;

(ë) cdo kerkese tjeter qe mund te percaktohet nga enti prokurues, ne perputhje me kete ligj dhe me rregullat e prokurimit.

(3) Nje ftese per procedure parakualifikuese duhet te njoftohet, ne te njejten menyre sic veprohet per ftesen ne proceduren e tenderit te hapur duke ju permbajtur kufijve kohore te percaktuar ne rregullat e prokurimit per proceduren parakualifikuese dhe duhet te permbaje te pakten informacion per:

- (a) emrin dhe adresen e entit prokurues;
- (b) nje pershkrim te shkurter te qellimit te fteses, bashke me nje permbledhje te natyres dhe sasise se mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve, per te cilat do te perdoret parakualifikimi;
- (c) menyrat si do te merren dokumentet e parakualifikimit, vendin ku mund te merren ato, si dhe vendin dhe afatin e fundit te paraqitjes se kerkesave per parakualifikim.

(4) Enti prokurues duhet te marre vendim lidhur me kualifikimin e cdo kandidati qe paraqet kerkesen per parakualifikim. Ne marrjen e ketij vendimi enti prokurues duhet te zbatoje vetem kriteret e percaktuara ne dokumentet e parakualifikimit.

Neni 14

Specifikimet teknike

(1) Specifikimet teknike dhe pershkrimi i mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te percaktuar sa me sakte dhe ne menyre sa me te plote objektin e prokurimit dhe per te krijuar kushte per nje procedure te paanshme e te hapur ndermjet te gjithë kandidateve.

(2) Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e entit prokurues ne lidhje me cilesine, funksionimin, sigurine dhe dimensionet, simbolet, terminologjine, ambalazhimin, marketimin dhe etiketimin, ose proceset dhe metodat per prodhimin e tyre dhe kerkesat lidhur me procedurat e vleresimit.

(3) Specifikimet teknike, te pershkruara nga enti prokurues, kur eshte e mundur:

(a) do t'i referohen funksionimit dhe jo vizatimit apo karakteristikave pershkruese; dhe

(b) do te mbeshteten ne standartet nderkombetare, per rastet kur keto standarte ekzistojne, ose perndryshe, ne standarde te njohura kombetare a ne kode te ndertimit.

(4) nuk duhet te kete asnje kerkese ose reference per karakteristika teknike te markes ose emrit, patentes, vizatimit a tipit, origjines se prodhuesit ose dhenesit te sherbimit, me perjashtim te rasteve kur nuk eshte e mundur qe kerkesat e prokurimit te pershkruhen ne menyre te mjaftueshme e te kuptueshme dhe me kusht qe ne dokumentet e tenderit te perfshihen fjale te tilla si "ose ekuivalent".

Neni 15

Refuzimi i te gjitha ofertave, propozimeve ose kuotimeve

(1) Enti prokurues mund t'i refuzoje te gjitha ofertat, propozimet dhe kuotimet ne cfaredo kohe para njoftimit te ofertes, propozimit ose kuotimit fitues, ne rast se nje gje e tille eshte e specifikuar ne dokumentet e tenderit ose te kerkeses per propozim a kuotim, dhe me kusht qe refuzimi i tyre te justifikohet me argumente te forta ekonomike. Enti prokurues duhet t'i komunikojë cdo kandidati qe ka paraqitur nje oferte, propozim ose kuotim, arsyet e ketij refuzimi, pa qene i detyruar t'i justifikojë ato.

(2) Enti prokurues, ne baze te paragrafit (1) te ketij neni, nuk do te kete asnje pergjegjesi ndaj kandidateve qe kane paraqitur oferta.

(3) Njoftimi per refuzimin e ofertave, propozimeve ose kuotimeve duhet t'u dergohet menjehere te gjithë kandidateve qe i kane paraqitur ato.

(4) Ne qofte se vendimi per refuzimin e te gjitha ofertave, propozimeve dhe kuotimeve merret para afatit te fundit te paraqitjes se tyre, ato duhen te kthehen te pahapura te kandidatet qe i kane paraqitur.

Neni 16

Veprimet korruptive

Enti prokurues duhet te refuzoje nje oferte, propozim ose kuotim, ne rast se kandidati qe e ben ate jep ose premton te jape drejtperdrejt ose terthorazi, cdo zyrtari te tanishem apo te meparshem ose nepunesi te entit prokurues a organeve te tjera, nje shperblim ne cfaredo forme, nje punesim ose cdo sherbim apo vlefte, si stimul per nje akt, vendim ose procedure, qe do te ndermarre enti prokurues lidhur me procedurat e prokurimit. Refuzimi dhe arsyet per nje veprim te tille duhet te shkruhen ne procesverbalet e procedurave te prokurimit dhe duhet t'i njoftohen zyrtarisht menjehere kandidatit.

Çdo shperblim i dhene ose i marre per perfitim vetjak nga nepunesit e enteve prokuruese ose te organeve nga te cilat ato kane varesi, si stimul per nje akt, vendim ose procedure prokurimi, quhet veprim korruptiv dhe, kur nuk perben veper penale, vleresohet si shkelje administrative dhe denohet sipas dispozitave te ketij ligji.

KREU IV

ZGJEDHJA E PROCEDURES SE PROKURIMIT

Neni 17

Procedura e prokurimit

(1) Enti prokurues, me perjashtim te rasteve te parashikuara ndryshe ne kete kre, duhet te perdore "Tenderin e hapur" si procedure te preferuar te prokurimit.

(2) Enti prokurues mund te perdore nje procedure tjeter, pervec tenderit te hapur, vetem ne rastet e parashikuara ne nenet 18, 19, 20, 21 dhe 22.

(3) Keshilli i Ministrave, ne raste te vecanta, emergjente ose te forcave madhore, mund te lejoje perdorimin e nje procedure prokurimi, pervec tenderit te hapur, ne situatat e parashikuara ne nenet 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Lejimi i nje procedure prokurimi duhet te shoqerohet me keto dokumente:

- a) Kerkesa e entit prokurues per perdorimin e procedures se zgjedhur te prokurimit dhe argumentet perkatese per zgjedhjen e kesaj procedure.
- b) Motivimi i entit prokurues per zgjedhjen e kandidatit ose te kandidateve qe do te marrin pjese ne prokurim publik.
- c) Treguesit qe vertetojne regjistrimin ne gjykate te kandidatit ose te kandidateve pjesemarres ne prokurim, veprimtarine e tyre, seriozitetin dhe besueshmerine.
- c) Te dhenat per percaktimin e fondit limit dhe per vellimin e punes per ndertimet.

(4) Enti prokurues duhet te planifikoje prokurimet e tij ne menyre racionale dhe asnje kerkese per prokurimin e nje sasie te dhene te mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve nuk duhet te ndalet me qellim qe te shmanget nje procedure e prokurimit, e percaktuar ne kete ligj ose ne rregullat e prokurimit.

(5) Enti prokurues per objekte te medha publike, afati kohor i ndertimit te te cilave kerkon vazhdimin e punimeve edhe ne vitin kalendarik pasardhes, prokuron fondet per ndertimet dhe supervizionin e tyre, sipas vleres se plote te ketyre objekteve. Çdo objekt i prokuruar per vleren e plote, shtrire ne me shume se nje vit kalendarik, detyrimisht perfshihet ne buxhetin e vitit pasardhes per vazhdimin dhe perfundimin e punimeve te tij.

Neni 18

Kushtet per perdorimin e "Tenderit te kufizuar"

Enti prokurues mund te perdore prokurimin nepermjet "Tenderit te kufizuar", ne perputhje me Nenin 36, kur:

(a) mallrat, ndertimet ose sherbimet jane te disponueshme vetem nga nje numer i kufizuar **subjektesh**;

(b) vlefte e perllogaritur e kontrates eshte brenda nje kufiri monetar, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

Neni 19

Kushtet per perdorimin e "Prokurimit te drejteperdrejte"

(1) Enti prokurues mund te perdore prokurimin e drejteperdrejte, ne perputhje me Nenin 37, ne rast se kjo procedure nuk do te perdoret me qellim qe te shmange konkurrencen e mundshme, ose ne nje menyre e cila do te shkaktonte nje diskriminim ndermjet kandidateve:

(a) kur ne mungese te konkurrences per arsye teknike, mallrat ndertimet ose sherbimet sigurohen vetem nga nje kandidat ose kur nje furnizues ose kontraktues ka te drejten ekskluzive per mallrat per ndertimet ose per sherbimet dhe nuk ekziston nje mundesi

tjeter zevendesuese;

(b) sipas kufizimeve te parashikuara ne rregullat e prokurimit, per levrime shtese te mallrave dhe te sherbimeve nga furnizuesi i meparshem, te cilat behen ose si zevendesim ose si shtim i mallrave dhe i sherbimeve ekzistuese, kur nje ndryshim i furnizuesit do te detyronte entin prokurues te prokuronte mallra a sherbime, te cilat nuk do te plotesonin kerkesat e pershtatshmerise me mallrat ose me sherbimet ekzistuese;

(c) sipas kufizimeve te parashikuara ne rregullat e prokurimit, kur sherbimet suplementare te ndertimit, te cilat nuk perfshiheshin ne kontraten fillestare **dhe kur vlera e kontrates nuk eshte me e madhe se 30 perqind e vleresse kontrates fillestare**, per shkak te rrethanave te paparashikueshme, jane bere te domosdoshme pasi ndarja e sherbimeve suplementare te ndertimit nga kontrata fillestare do te ishte e veshtire per arsye teknike ose ekonomike;

(ç) **cfuqizohet**

(d) per vazhdimin e sherbimeve konsultuese, ku kontrata origjinale eshte zbatuar ne menyre te kenaqshme dhe vazhdimi i ketyre sherbimeve mund te sjelle avantazhe ekonomike dhe efektivitet;

(dh) per blerjen e mallrave qe prishen si fruta-zarzavate te fresketa ose te artikujve te tjere te ngjashem, te cilet prokurohen duke respektuar kushtet e tregut;

(e) per rastet e blerjes se mallrave ne kushte jashtezakonisht te favorshme, qe shfaqen vetem ne nje kohe te shkurter; kjo dispozite synon te trajtoje shitjet jo te zakonshme te mallrave nga persona juridike, te cilet normalisht nuk jane furnizues; kjo dispozite nuk synon te mbuloje prokurimet e zakonshme nga furnizues te rregullt.

(ë) per vazhdimin e sherbimeve te projektimit qe jane te lidhura me sherbime te tjera te kryera me pare, te cilat, po t'i jepen nje subjekti te ri, do te cenonin te drejten e autorit;

enti prokurues do te perdore proceduren e prokurimit te drejtperdrejte per rastet e parashikuara ne shkronjat "a", "b", "c", "ç" te pikes 1 te ketij neni, vetem pasi te kete marre miratimin nga Agjencia e Prokurimit Publik;

(f) kur enti prokurues ka nevojte urgjente per mallra per ndertime ose per sherbime si dhe per ceshtje te sigurise kombetare dhe kur kjo nevojte urgjente eshte shkaktuar jashte kontrollit te entit prokurues, enti prokurues mund te perdori prokurimin e drejteperdrejte, pasi te jete marre me pare miratimi nga Agjencia e Prokurimit Publik.;

(2) Enti prokurues mund te perdore, gjithashtu, prokurimin e drejtperdrejte per prokurimet me vlera te vogla, kur vlera e perlogaritur eshte me e vogel se kufiri monetar, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

Neni 20

Kushtet per perdorimin e "Tenderit me dy faza"

Enti prokurues mund te perdore prokurimin nepermjet "Tenderit me dy faza", ne perputhje me nenin 38, ne rastet e nje kontrate me vlefte te madhe dhe komplekse, per prokurimin e mallrave dhe ndertimeve, per te cilat procedura e tenderit nuk eshte e pershtatshme, per shkak te veshtiresise ne percaktimin e sakte te mallrave e ndertimeve, duke kerkuar :

(a) ne fazen e pare, oferta me informacion teknik te plote pa cmime ne lidhje me menytrat e ndryshme te mundshme per plotesimin e nevojave te tij, pas se ciles,

(b) ne fazen e dyte, oferta me cmime ne baze te specifikimeve teknike dhe te dhenave te tjera, te zgjedhura nga faza e pare.

Neni 21

Kushtet per perdorimin e "Kerkeses per propozim"

Enti prokurues mund te perdore prokurimin nepermjet "Kerkeses per propozim", ne perputhje me nenin 39, kur ai kerkon te marre sherbime konsultative ose sherbime te tjera per te cilat procedura e tenderit nuk eshte e pershtatshme per shkak te veshtiresise ne

percaktimin e sakte te sherbimeve.

Neni 22

Kushtet per perdorimin e "Kerkeses per kuotim"

Enti prokurues mund te perdore prokurimin nepermjet "Kerkeses per kuotim", ne perputhje me nenin 40, per blerjen e mallrave te gatshme dhe per prokurimin e ndertimeve dhe sherbimeve per te cilat ka treg te stabilizuar, me kusht qe vlera e perlogaritur e kontrates te jete brenda nje kufiri monetar, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

KREU V

"TENDERI I HAPUR"

Neni 23

Dispozitat baze lidhur me "Tenderin e hapur"

Enti prokurues do te perdore "Tenderin e hapur" kur vlefte e perlogaritur e kontrates eshte mbi nje kufi monetar, i percaktuar ne rregullat e prokurimit. Enti prokurues mund te perdore tenderin e hapur kur mallrat, ndertimet dhe sherbimet qe do te prokurohen jane te sigurueshme nga burimet e brendshme dhe me konkurrence te mjaftueshme brenda vendit duke respektuar ne cdo rast nenin 9. Ne proceduren e "Tenderit te hapur" do te perdoren dispozitat baze te meposhtme.

Neni 24

Ftesa per oferte

Ftesa per oferte duhet te permbaje te pakten:

- (a) emrin dhe adresen e entit prokurues;
- (b) nje perskrim te shkurter te mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duke perfshire kohen qe kerkohet per dorezimin ose perfundimin e tyre;
- (c) menytrat dhe kushtet per marrjen e dokumenteve te tenderit dhe vendin ku mund te merren keto dokumente;
- (ç) vendin dhe afatin e fundit te paraqitjes se ofertave;
- (d) vendin dhe kohen e hapjes se ofertave, bashke me njoftimin qe ofertuesit ose perfaqesuesit e autorizuar prej tyre jane te lejuar te ndjekin hapjen e ofertave.

Neni 25

Njoftimet

(1) Ftesa per oferte duhet t'u drejtohet te gjithe kandidateve te cilet kane shfaqur interesin e tyre me shkrim, per te marre pjese ne nje procedure prokurimi. Ftesa per oferte duhet te botohet, ne Buletinin e Prokurimit Publik dhe te pakten ne dy gazeta kombetare me tirazh te madh.

(2) Koha e lejuar per pergatitjen e ofertes nuk duhet te jete me pak se minimumi i diteve, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

Neni 26

Dokumentet e tenderit

Dokumentat e tenderit duhet te permbajne informacion te mjaftueshem, ne menyre qe konkurrenca ndermjet ofertuesve ne tender te behet mbi bazen e kushteve te plota, te paanshme dhe objektive. Dokumentet e tenderit duhet te permbajne te pakten:

- (a) udhezimet per pergatitjen dhe paraqitjen e ofertave;
- (b) informacionet per afatin e fundit te pranimit te ofertave, adresen ku duhen derguar ato, daten, oren, vendin ku do te behet hapja e tyre, si dhe njoftimin qe ofertuesit ose perfaqesuesit e autorizuar prej tyre jane te lejuar te ndjekin hapjen e ofertave;
- (c) formularet e ofertes dhe, ne rastet kur eshte e zbatueshme, format e sigurimit te ofertes qe do te perdoren;
- (ç) numrin e kopjeve, te cilat do te paraqiten bashke me origjinalin e ofertes;
- (d) kushtet e pergjithshme dhe specifike te kontrates; ne rastin e ndertimeve mund te parashikojte edhe mbikqyrjen dhe marrjen ne dorezim te tyre;
- (dh) specifikimet e plota te kerkesave te mallrave, ndertimeve dhe sherbimeve, duke perfshire edhe kohen e kerkuar te dorezimit a te perfundimit te tyre;
- (e) informacionet qe duhen te jepen nga ofertuesi per te demonstruar kualifikimet e tij, si dhe permbushjen e detyrimeve fiskale dhe te sigurimeve shoqerore;
- (ë) periudhen gjate se ciles oferta duhet te jete e vlefshme;
- (f) kriteret per vleresimin e ofertave dhe shpalljes se ofertes fituese;
- (g) nje rezerve ku te shprehet se enti prokurues mund t'i refuzoje te gjitha ofertat ne cfaredo kohe perpara njoftimit te ofertes fituese.

Neni 27

Disponueshmeria e dokumenteve te tenderit

Dokumentet e tenderit do t'u vihen ne dispozicion kandidateve brenda nje kohe sa me te shkurter, me nje cmim qe te mos e kaloje koston e riprodhimit dhe dorezimit te tyre deri te kandidatet, ne menyren e specifikuar ne ftesen per oferte.

Neni 28

Modifikimet ne dokumentet e tenderit

Enti prokurues, ne cfaredo kohe perpara mbarimit te afatit te fundit te paraqitjes se ofertave, me iniciativen e tij ose ne pergjigje te nje kerkese nga nje kandidat, i cili ka blere dokumentet e tenderit, mund t'i modifikojte ato duke hartuar shtojce, e cila behet pjese perberese e dokumenteve te tenderit. Cdo shtojce duhet t'i njoftohet menjehere te gjithë kandidateve te mesiperm. Ne qofte se enti prokurues e konsideron te nevojshme te modifikojte dokumentet e tenderit dhe modifikimi behet brenda nje periudhe kohe me pak se 1/3 e numrit te diteve te percaktuar per pergatitjen e ofertave, enti prokurues duhet te shtyje deri me te njejten periudhe kohe afatin e fundit te paraqitjes se ofertave, ne vartesi nga objekti i prokurimit.

Neni 29

Sigurimi i tenderit

(1) Enti prokurues duhet te percaktojte ne dokumentet e tenderit kushtin e sigurimit te ofertes ne formen e garancise bankare ose te garancise se leshuar nga shoqerite e sigurimeve, te licensuara nga shteti. Vlera e ketij sigurimi duhet te jete e mjaftueshme per te dekurajuar ofertat e papergjegjeshme dhe duhet te jete brenda kufirit monetar, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

(2) Sigurimi i ofertes duhet te konfiskohet nga enti prokurues, ne rast se nje ofertues

terheq oferten e tij brenda periudhes se vlefshmerise se ofertes, ose ne rastin e nje ofertuesi fitues, i cili heq dore nga lidhja e kontrates ose nuk eshte ne gjendje te jape sigurimin e permbushjes se detyrimeve te kontrates, ne qofte se do te kerkohet nje sigurim i tille.

Neni 30

Paraqitja dhe pranimi i ofertave

(1) Ofertat duhet te paraqiten me shkrim, te nenshkruara, te vulosura dhe te mbyllura ne nje zarf, ne vendin, daten dhe oren e caktuar per paraqitjen e ofertave, te percaktuar ne ftesen per oferte. Zarfi i ofertes permban dokumentacionin per kualifikimin e kandidateve dhe oferten tekniko – ekonomike . Ne tenderat nderkombetar ofertat mund te pranojne edhe para dates se per caktuar per hapjen e tyre duke percaktuar ne ftesen per oferte afatin e fundit te paraqitjes se tyre. **Ne te gjitha rastet** enti prokurues, mbi bazen e kerkeses, do te pajise ofertuesin me nje dokument ku tregohet data dhe koha e marrjes se ofertes se tij.

(2) Ofertat e marra pas mbarimit te afatit te fundit te paraqitjes tyre, duhet t'u kthehen te pahapura kandidateve qe i kane paraqitur ato.

(3)Ofertuesi ,qe ka dorezuar oferten para afatit te fundit te dorezimit ,ka te drejte ta zevendesoje ose ta terheqe ate ,me perjashtim te dites se fundit te hapjes se tenderit

Neni 31

Hapja e ofertave

(1) Enti prokurues duhet te hape te gjitha ofertat ne daten dhe ne kohen e percaktuar ne dokumentet e tenderit, te cilat vijne menjehere pas afatit te fundit te pranimit te tyre.

(2) Ofertuesit ose perfaqesuesit te autorizuar prej tyre duhet te lejohen te marrin pjese ne hapjen e ofertave.

(3) **Emri i ofertuesit dhe vleftha totale e cdo oferte duhet te lexohen me ze te larte dhe te regjistrohet ne procesverbal dhe, ne baze te kerkeses, cdo ofertuesi duhet t'i vihet ne dispozicion nje kopje e ketij procesverbali.**

(4) **Cfuqizohet**

Neni 32

Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave

(1) Enti prokurues kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, me qellim qe shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave te jete i drejte dhe transparent. Nuk duhet te kerkohet, ofrohet a lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, duke perfshire ndryshime ne cmime.

(2) Enti prokurues, pavaresisht nga paragrafi (1), duhet te korrigoje vetem gabimet aritmetike qe do te zbulohen gjate shqyrtimit te ofertave. Enti prokurues duhet te njoftoje menjehere per keto korrigjime ofertuesin qe ka paraqitur oferten.

(3) Enti prokurues, duke respektuar paragrafin (4), duhet ta konsideroje nje oferte te vlefshme vetem ne qofte se ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

(4) Enti prokurues konsideron nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te cilat nuk ndryshojne materialisht ose devijojne nga karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, ose edhe ne qofte se oferta permban gabime apo lapsus te cilat mund te korrighohen pa prekur permbajtjen e ofertes. Te gjitha devijimet e tilla do te mblidhen, sa te jete e mundur, dhe do t'u kushtohet vemendja e duhur ne vleresimin dhe krahasimin e ofertave.

(5) Enti prokurues nuk duhet te shpalle fitues nje ofertues kur:

- (a) ai nuk ka demonstruar per kualifikimin e tij, sipas menyres te kerkuar ne Nenin 26 (e);
- (b) ai nuk pranon korrigjimin e nje gabimi aritmetik, i bere sic pershkruhet ne paragrafin (2) te ketij Neni;
- (c) oferta e tij nuk eshte e vlefshme;
- (ç) ai ka ofruar nje stimul sipas Nenit 16.
- (6) Enti prokurues duhet te vleresoje dhe te krahasoje ofertat qe jane te vlefshme, me qellim qe te percaktoje oferten fituese, sic shprehet ne paragrafin (7), ne perputhje me procedurat dhe kriteret qe permbahen ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter qe nuk permbahet ne dokumentet e tenderit.
- (7) Oferta fituese duhet te jete oferta qe, ne baze te kerkesave dhe kriterëve te percaktuara ne dokumentet e tenderit, ploteson kerkesat e objektit te prokurimit me :
- (a) vleften me te ulet, ose
- (b) Vlera ekonomike me e mire vleresohet ne baze te kriterëve te specifikuara ne dokumentat e tenderit, kriteret e cilat duhet te jene objektive dhe te shprehura qarte nga ana sasioredhe, per qellim te vleresimit te tenderit ,duhet te shprehen me terma monetare
- (8) Enti prokurues duhet te pergatise nje raport vleresues, qe te permbaje nje permbledhje te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave.

Neni 33

Perpunimi i dokumentave duhet te jete i fshehte

- (1) Pas hapjes se ofertave, informacionet ne lidhje me shqyrtimin, vleresimin e ofertave dhe rekomandimet per oferten fituese nuk duhet t'u behen te njohura ofertuesve a personave te tjere, qe nuk jane te angazhuar zyrtarisht ne kete proces, derisa te nenshkruhet kontrata.
- (2) Pas hapjes se ofertave dhe deri ne shpalljen e ofertes fituese, asnje ofertues nuk duhet t'i beje asnje komunikim te pajustificuar entit prokurues ose te perpiqet ne cfaredolloj menyre per te ndikuar ne shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave.

Neni 34

Ofertuesve nuk do t'u kerkohej te modifikojne ofertat e tyre

Nje ofertuesi, si kusht per shpalljen e tij fitues, nuk duhet t'i kerkohej qe te ndermarre pergjegjesi qe nuk jane percaktuar ne dokumentet e tenderit, te ndryshoje vleften e ofertes se tij ose te modifikojte, ne cfaredolloj menyre, oferten e tij.

Neni 35

Njoftim i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates

- (1) Enti prokurues, perpara perfundimit te periudhes se vlefshmerise se ofertes, duhet te njoftoje ofertuesin, oferta e te cilit eshte shpallur fituese.
- (2) Njoftimi i ofertes fituese do te sherbeje per hartimin e kontrates ndermjet paleve, e cila duhet te nenshkruhet brenda kohes se percaktuar ne dokumentet e tenderit. Njoftimi duhet te permbaje te pakten vleften totale te kontrates, kerkesen per paraqitjen e sigurimit te permbushjes se detyrimeve te kontrates dhe per nenshkrimin e formularit te kontrates nga ana e ofertuesit.
- (3) Ekzistenca e nje kontrate duhet te konfirmohet me ane te nenshkrimit te formularit te kontrates, e cila permban te gjitha detyrimet ndermjet paleve. **Ne se ofertuesi fitues, brenda afatit kohor te percaktuar ne dokumentat e tenderit ,nuk nenshkruan formularin e kontrates ose nuk ben sigurimin e kontrates, enti prokurues ben kanfiskimin e sigurimit te ofertes dhe ne se diferenca ndermjet ofertes se klasifikuar ne vendin e pare dhe te dyte do te jete jo me e madhe se vlera e sigurimit te ofertes, atehere do te shpallet si fitues pjesmarsi I renditur I dyti ne klasifikim .**
- (4) Enti prokurues, brenda 30 diteve te nenshkrimit te formularit te kontrates duhet te

publikoje njoftimin e fituesit ne Buletinin e Prokurimit Publik. Kontrata per prokurimet publike quhet e lidhur, kur nenshkruhet nga enti prokurues dhe nga ofertuesi fitues.

- (5) Per kontraten e prokurimit publik zbatohen dispozitat e Kodit Civil.
- (6) Enti prokurues ose organi, i cili ve ne dispozicion fondet pas lidhjes se kontrates, ushtron mbikeqyrjen per permbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga kontrata.
- (7) Proçedura e prokurimit perfundon, kur realizohen te gjitha detyrimet kontraktore te paleve

KREU VI

PROCEDURA TE TJERA PROKURIMI

Neni 36

Procedura e "Tenderit te kufizuar"

Procedura e "Tenderit te kufizuar" eshte e njejte me ate qe zbatohet ne tenderin e hapur, me perjashtim qe:

(a) Ftesa per oferte i adresohet **te gjithë kandidatëve të specializuar, te njohur nga enti prokuruesar**, per te siguruar jo me pak se tri oferta, te cilet kane deklaruar ose mund te deklarojne interesimin e tyre per te paraqitur oferta. Perzgjedhja duhet te behet ne nje menyre jodiskriminuese dhe numri i kandidatëve te ftuar duhet, nese eshte e mundur, te jete i mjaftueshem per te siguruar nje konkurrence te efektshme. **Jane te lire te marrin pjese ne kete procedure dhe kandidatë të tjerë ,që kanë marrë dëjën për tenderin ;**

(b) Enti prokurues, i cili ka lista te perditesuara, rregullisht, te pakten dy here ne vit, duhet te zgjedhe kandidatë nga keto lista dhe te pranoje oferta nga ata kandidatë te cilet kerkojne per te marre pjese ne tender, duke u dhene te gjithë pjesemaresve mundesi te barabarta konkurimi.

(c) Koha e lejuar per pergatitjen e ofertave nuk duhet te jete me pak se minimumi i diteve, i percaktuar ne rregullat e prokurimit.

(ç) Enti prokurues mund te vendose, ne vartesi nga rrethanat, ne qofte se duhet te paraqitet ose jo sigurimi i ofertes.

(d) Enti prokurues per zhvillimin ose jo te procedurave te prokurimit me me pak se tri oferta, duhet te marre me pare miratimin e Agjencise se Prokurimit Publik.

Neni 37

Procedura e "Prokurimit te drejtperdrejte"

(1) Kur enti prokurues perdor "Prokurimin e drejtperdrejte", sipas Nenit 19 (1), ai duhet te pergatite nje pershkrim te nevojave te tij dhe cdo kerkese tjeter lidhur me sasine, cilesine, kushtet dhe kohen e kerkuar te dorezimit dhe do te jete i lire te negocioje me kandidatin e vetem. Cdo marreveshje e arritur nepermjet prokurimit te drejtperdrejte sipas Nenit 19 (1) duhet te konfirmohet nga nje kontrate e nenshkruar nga te dy palet.

(2) Prokurimi i drejtperdrejte sipas Nenit 19 (2) nuk kerkon kontrate ose dokument tjeter, pervec dokumentit te rregullt qe verteton blerjen e mallit.

Neni 38

Procedura e "Tenderit me dy faza"

(1) Kur enti prokurues perdor "Tenderin me dy faza", ai duhet te zgjedhe kandidatet qe do te ftohen per oferte, ne baze te procedures se parakualifikimit sipas Nenit 13.

(2) Ne fazen e pare, enti prokurues duhet te ftoje kandidatet e parakualifikuar per te paraqitur ofertat pa cmime, por duke perfshire nje pershkrim te plote te aftesise teknike, cilesise ose karakteristikave te tjera te mallrave ose ndertimeve, te cilat ato i konsiderojne me te mira per te plotesuar nevojat e entit prokurues. Ne kete faze enti prokurues mund te negocioje me cdo kandidat ne lidhje me cdo aspekt te ofertes se tij.

(3) Ne fazen e dyte, enti prokurues duhet te kerkoje oferta me cmime ne baze te specifikimeve teknike dhe te dhenave te tjera te zgjedhura nga faza e pare, prej kandidateve qe kane paraqitur oferta te kenaqshme ne fazen e pare.

(4) Per shpalljen e ofertes fituese ne baze te ofertave te paraqitura ne fazen e dyte, do te perdoren dispozitat e kreut V.

Neni 39

Procedura e "Kerkeses per propozim"

(1) Kur enti prokurues perdor "Kerkese per propozim", kerkesa per propozim duhet t'i adresohet jo me pak se tre dhe jo me shume se shtate kandidate, te zgjedhur prej entit prokurues.

(2) Nje kerkese per propozim duhet te permbaje te pakten informacionin e meposhtem:

(a) Emrin dhe adresen e entit prokurues.

(b) Pershkrimin e sherbimit te kerkuar, normalisht nepermjet termave te references.

(c) Ne rastin e detyrave te konsulencave, te cilat mund te shkaktojne konflikte te interesave, nje kujtese qe kandidatet per konsulenca te tilla duhet te perjashtojne vetveten nga prokurimi i mallrave dhe ndertimeve, te cilat mund te pasojne, ose te kene lidhje me keto konsulenca.

(g) Kriteret per vleresimin e propozimeve, peshen relative qe do t'i jepet cmimit dhe cdo kriteri, dhe proceduren si do te zbatohen keto kriteret ne vleresimin e propozimeve.

(d) Vendin dhe afatin e fundit per paraqitjen e propozimeve.

(3) Enti prokurues mund te kryeje negociata me kandidatin fitues per permbajtjen e propozimit te tij dhe mund te kerkoje ose te lejoje rishqyrtimin e ketij propozimi.

(4) Shpallja e propozimit fitues nga enti prokurues duhet te behet per kandidatin propozimi i te cilit ploteson me mire nevojat e entit prokurues, sic eshte percaktuar ne perputhje me kriteret dhe procedurat per vleresimin e propozimeve, te shprehura ne kerkesen per propozime.

Neni 40

Procedura e "Kerkeses per kuotim"

(1) Enti prokurues duhet te kerkoje kuotime nga sa me shume kandidate qe te jete e mundur, per te siguruar jo me pak se tri oferta. Ne rast se sigurohen me pak se tri oferta, enti prokurues duhet te marre miratimin e Agjencise se Prokurimit Publik per vazhdimin ose jo te kesaj procedure.

(2) Kerkesa e entit prokurues duhet te permbaje nje pershkrim te qarte per kerkesat e objektit te prokurimit lidhur me cilesine, sasine, kushtet dhe kohen e kerkuar per dorezim si dhe kerkesa te tjera te vecanta.

(3) Shpallja e kuotimit fitues duhet te behet per kandidatin qe ploteson kerkesat e entit prokurues, te percaktuar ne paragrafin (2) me kuotimin me te ulet.

(4) Enti prokurues duhet te lidhe kontrate me kandidatin fitues.

KREU VII

PROCEDURAT NDERKOMBETARE

Neni 41

" Tenderi i hapur nderkombetar "

(1) Enti prokurues duhet te perdore "Tenderin e hapur nderkombetar" kur vlera e perlllogaritur e fondit limit eshte mbi nje kufi monetar te percaktuar ne rregullat e prokurimit ose per fonde limite nen kete vlere monetare, ku konkurrenca e frytshme nuk mund te sigurohet ne tenderin e hapur per prokurimin e mallrave, te ndertimeve dhe te sherbimeve, pa pjesemarjen e personave fizike ose juridike te huaj.

(2) Nje procedure e tenderit te hapur nderkombetar duhet te respektoje dispozitat e kreut V dhe dispozitat e meposhtme :

(a) Ftesa per oferte dhe dokumentet e tenderit do te jene ne shqip dhe ne nje gjuhe tjetere qe perdoret gjeresisht ne tregtine nderkombetare.

(b) Ftesa per oferte duhet te njoftohet ne nje gazete qe perdor po ate gjuhe qe eshte perdorur ne ftese dhe qe ka tirazh te mjaftueshem per te terhequr konkurrencen nderkombetare.

(c) Afati i fundit i paraqitjes se ofertave, i percaktuar ne rregullat e prokurimit, duhet te jete i mjaftueshem qe t'u jape mundesi kandidateve te informohen per ftesen dhe te kene kohe te mjaftueshme per te pergatitur dhe paraqitur ofertat e tyre.

(ç) Specifikimet teknike, mundesisht sa me te pershtatshme ne kerkesat kombetare duhet te mbeshteten ne standardet nderkombetare, ose ne standardet qe perdoren gjeresisht ne tregtine nderkombetare.

(d) Kandidatet do te lejohen te paraqesin ofertat e tyre, si dhe cdo dokument sigurimi qe ato mund te paraqesin, ne monedhat e tyre kombetare, ose ne nje monedhe qe perdoret gjeresisht ne tregtine nderkombetare dhe qe permendet ne dokumentet e tenderit.

(dh) Kushtet e pergjithshme dhe specifike te kontrates do te jene te tilla qe perdoren gjeresisht ne tregtine nderkombetare.

Neni 42

Procedurat e tjera nderkombetare

Kurdohere qe konkurrenca e efektshme per nje kontrate nuk mund te arrihet pa pjesemarrjen e personave fizike dhe juridike te huaj ne procedura te tjera, pervec tenderit te hapur nderkombetar, ne procedurat e tilla si tenderi i kufizuar ose me dy faza apo kerkese per propozim, duhet te perdoren dispozitat e parashikuara ne nenin 41 (2), per aq sa eshte e mundur, si dhe ato te parashikuar ne kreun VI.

KREU VIII

ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 43

Te pergjithshme

(1) Sipas dispozitave te ketij ligji, cdo kandidat eshte i lire te kerkoje shqyrtim administrativ per nje veprim ose neglizhence te kryer nga nje ent prokurues, qe kandidati e konsideron si shkelje te ketij ligji ose te rregullave dhe udhezimeve te prokurimit.

(1/1) **Paraqitja e ankeses tek titullari i entit prokurues ose tek Agjencia e Prokurimit Publik pezullon shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontrates deri ne kthimin e pergjigjes sipas kompetencave dhe afateve te parashikuara ne nenet 44 dhe 45 te ketij ligji ;**

(2) Pikat e meposhtme nuk do t'i nenshtrohen rishqyrtimit te parashikuar ne

paragrafin (1) te ketij Neni:

- (a) Caktimi i nje procedure prokurimi, ne baze te kreut IV.
 - (b) Vendimi i marre nga enti prokurues ne baze te nenit 15 per te refuzuar te gjitha ofertat, propozimet ose kuotimet.
 - (c) Vendimi i marre nga enti prokurues me miratimin e Keshillit te Ministrave.
- (3) Pasi enti prokurues ka lidhur kontrate me kandidatin e ofertes ose propozimit fitues, asnje ankese per nje veprim a neglizhence ne proceduren qe ka cuar ne ate faze, nuk do te paraqitet per t'u shqyrtuar ne rruge administrative.

Neni 44

Shqyrtimi nga kryetari i entit prokurues

(1) Nje ankese ndaj nje veprimi apo neglizhence te entit prokurues do t'i paraqitet fillimisht kryetarit te entit prokurues.

(2) Me perjashtim te rasteve kur ankesa eshte zgjidhur me marreveshje te perbashket, kryetari i entit prokurues do te pezulloje proceduren e prokurimit dhe, brenda 15 diteve pas dorezimit te ankeses, duhet te nxjerre nje urdher me shkrim ku te jape arsyet dhe, ne rast se ankesa eshte quajtur e vlefshme, te tregoje masat korrigjuese.

(3) Ne rast se kryetari i entit prokurues nuk do te nxjerre nje urdher me shkrim brenda kohes se percaktuar ne paragrafin (2), ose ne qofte se kandidati nuk eshte i kenaqur me vendimin e Kryetarit te entit prokurues, ai paraqet ankesen ne organin qendror ose lokal qe ve ne dispozicion fondin dhe, nese perseri nuk eshte i kenaqur nga zgjidhja e problemit kandidati ka te drejte te paraqese ankesen ne Agjencine e Prokurimit Publik.

Neni 45

Shqyrtimi nga Agjencia e Prokurimit Publik

(1) Agjencia e Prokurimit Publik me marrjen e ankeses se nje kandidati ofertues ne prokurimin publik, ne rast se nuk e refuzon ate, njofton menjehere entin prokurues te pezulloje veprimet e metejshme te prokurimit publik dhe i kerkon atij qe, brenda 5 diteve nga marrja e njoftimit, te depozitoje ne Agjencine e Prokurimit Publik te gjithe dokumentacionin qe lidhet me proceduren e prokurimit.

(2) Me perjashtim te rasteve kur Agjencia e Prokurimit Publik e refuzon ankesen ajo mund te urdheroje entin prokurues te mos ndermarre asnje veprim a vendim te paligjshem, ose te mos ndjeke asnje procedure te paligjshme; mund ta urdheroje entin prokurues te veproje ne perputhje me kete ligj dhe mund te anulloje teresisht ose pjeserisht, nje akt a vendim te paligjshem te entit prokurues, me perjashtim te vendimit per te shpallur oferten ose propozimin fitues.

(3) Perpara se te marre nje vendim lidhur me ankesen, Agjencia e Prokurimit Publik do te njoftoje kandidatin qe ka bere ankesen dhe do te marre ne konsiderate informacionin dhe argumentet qe ka marre nga ky kandidat dhe nga enti prokurues.

(4) Agjencia e Prokurimit Publik duhet te shpalle vendimin e vet brenda 30 diteve nga marrja e ankeses, duke shprehur arsyet e vendimit te saj, si dhe masat korrigjuese, nese ka.

(5) Vendimi i Agjencise do te jete perfundimtar.

KREU IX

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 46

Kundravajtjet administrative

(1) Ne rastet kur verehen shkelje te dispozitave te ketij ligji dhe te rregullave te prokurimit, Agjencia e prokurimit Publik ka te drejte:

a) t'i propozoje organit qendror ose vendor marrjen e masave ndeshkuese ndaj personave pergjegjes te entit prokurues, qe kane kryer kundervajtje administrative;

b) te denoje personat pergjegjes per kundervajtje administrative me gjobe nga 50 mije leke deri ne 1 milione leke. Kunder vendimit te denimit mund te behet ankese ne gjykatën e rrethit te entit prokurues brenda 5 diteve nga njoftimi.

(2) Titullari i organeve qendrore ose vendore, si dhe titullari i entit prokurues, kur veren shkelje te ketij ligji dhe te rregullave te prokurimit, ka te drejte:

(a) te denoje personat pergjegjes te entit prokurues per kundervajtjet administrative me gjobe nga 50 mije leke deri ne 100 mije leke. Kunder vendimit te denimit mund te behet ankim ne Agjencine e Prokurimit, e cila shqyrton ankimin brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se tij;

(b) te largoje nga detyra personat pergjegjes per kundervajtjet administrative;

(3) Vjelja e gjobave behet sipas ligjit nr.7697, date 7.4.1993 "Per kundervajtjet adeministrative".

(4) Gjoba e parashikuar ne kete nen per te njejten shkelje jepet vetem njehere.

Neni 47

Shfuqizimet

Te gjitha dispozitat qe bien ne kundershtim me kete ligj, shfuqizohen.

Neni 48

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi me 19 Maj 2001.

KRYETARI I KRYESISE

Skender Gjinushi